

Numri i lëndës: 2022:244641

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05506713

C.nr. 1017/2022

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË V., sipas gjyqtarit Raif Fazliu, me bashkëpunëtorin profesional Fitim Limani, në çështjen juridiko-civile të paditëses O.E. nga fshati Z., Komuna e V., te cilën me autorizim e përfaqëson avokati X.H.nga V., kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve Sigal nga Prishtina, me bazë juridike kompensim i dëmit jo material, vlera e kontestit 1.000 euro, jashtë seancës gjyqësore më datë 26.03.2024, bie këtë:

A K T V E N D I M
PËR TËRHEQJEN E PADISË

I.KONSTATOHET e tërhequr padia e ushtruar më datë 21.11.2022, nga paditësja O.E. nga fshati Z., Komuna e V., kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve Sigal nga Prishtina, me bazë juridike kompensim i dëmit jo material.

Lënda C.nr.1017/2022, konsiderohet e kryer dhe si tillë arkivohet nga Gjykata Themelore në Gjilan-Dega në V..

II.Secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësja O.E. nga fshati Z., Komuna e V., përmes të autorizuarit të saj, avokatit Xhavit Haziri, me parashtrësën e ushtruar më datë 26.03.2024, e ka tërhequr padinë e vet të ushtruar me datë 21.11.2022, me të cilën kishte paditur Kompaninë e Sigurimeve Sigal nga Prishtina. Paditësi ka bërë tërheqjen e padisë për kompensim i dëmit jo material, i cili e kishte arsyetuar tërheqjen me faktin se kishin arritur marrëveshje jashtëgjyqësore me të paditurën. Gjykata Themelore Gjilan-Dega në V., ka shqyrtuar kërkesën për tërheqjen e padisë dhe ka vendosur që padia e paditësit të konsiderohet e tërhequr.

Lënda C.nr.1017/2022, konsiderohet e kryer dhe si tillë arkivohet nga Gjykata Themelore në Gjilan-Dega në V..

Nga të cekurat më lartëshënuara në bazë të nenit 261 paragrafët 2, 3 dhe 4. të LPK-ës, gjykata, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Në bazë të nenit 450 të LPK-ës, secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË V.

C. nr. 1017/2022

Më: 26.03.2024

G j y q t a r i
Raif Fazliu

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi ushtrimi i ankesës nuk lejohet.